

Emri i Lëndës : Aftësi Gjuhësore Akademike I							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ELL 111	B	Vjeshtë	4.00	0.00	0.00	4.00	6.00
Lektori		Enriketa Sogutlu, Prof. Asoc. Dr.					
Asistenti		Albana Cekrezi, PhD					
Gjuha e kursit		Anglisht					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Silabusi i kësaj lënde gjithëpërfshirëse u ofron studentëve praktikim sistematik të të 4 aftësive, lexim, dëgjim, të folur dhe të shkruar në nivel të përparuar. Inkurajon përmirësimin e aftësisë së të lexuarit nëpërmjet një morie tekstesh dhe artikujsh nga fusha të ndryshme. Seksioni i gramatikës mundëson njohjen dhe praktikimin e strukturave gramatikore komplekse, ndërsa pjesa e fjalorit ndihmon njohjen me fjalorin/terminologjinë kryesore nga një shumëllojshmëri tematikash. Me anë të kësaj lënde studentët mund të arrijnë një nivel më të avancuar të njohurive dhe përdorimit aktiv të gjuhës angleze.					
Objektivat		Nëpërmjet kësaj lënde, studentët do të mund të përforcojnë njohuritë që kanë të bëjnë me struktura të ndryshme gramatike të gjuhës Angleze nëpërmjet një sërë ushtrimesh. Ata do të mund të përdorin ushtrime që kanë të bëjnë me të dëgjuarit si dëgjimi i kontrolluar që i drejton ata drejt zhvillimit të aftësive të të folurit të lirë. Përsa i përket aftësisë së të lexuarit, studentët duhet të praktikojnë aftësitë e të lexuarit si skimming, scanning, të lexuarit intensiv me një qëllim të caktuar, kuptimi i strukturës së tekstit e të tjera. Në pjesën e të shkruarit, studentët do të përmirësojnë aftësitë e tyre të të shkruarit, të shkruajnë letra, emaille, propozim, ese, raport, dhe ese narrative.					
Konceptet Kryesore		Të lexuarit, të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit, letra joformale dhe gjysmë formale, propozim, stil formal, lidhëza, struktura hipotetike, ese të bazuara mbi stimuj, e ardhmja, grada e sigurisë, format infinitive, foljet modale, foljet statike, e shkuara, sinonime, antonime.					
Programi i Lëndës							
Java		Tema					
1		Module 1. Fjalor, lidhje, jetë familjare, personalitete, cilësi, idioma, parafjalë, shprehje foljore, fjalëformim. Studentët diskutojnë rreth filmave dhe personazheve të preferuar. Fokusi i diskutimit mbetet familja, si ajo na lidh me të shkuarën dhe të ardhmen tonë.					
2		Të ndryshëm, por të ngjashëm. Teksti i leximit përmban historinë e dy vëllezërve binjakë, sa të ngjashëm po aq dhe të ndryshëm. Gjithashtu, studentet përveç diskutimit rreth tekstit, punojnë me fjalorin dhe realizojnë analizë më të detajuar të tij. Në përfundim, ata shkruajnë një blog mbi mënyrën se si motrat, apo vëllezërit mund të mirëkuptohen pavarësisht ndryshimeve që kanë.					
3		Fjalor, mbiemra që tregojnë lidhje, idioma, vecori të personalitetit, cilësi, flajëformim, gramatika në përdorim, përdorimi i: used to, would, get used to. Studentët kërkohet të bëjnë një shumëllojshmëri ushtrimesh në lidhje me fjalorin dhe përdorimin e saktë të foljeve të ngjashme si: stare, image, glimmer. Ushtrime të tjera lidhen me mbiemra si: tight-knit, distant, dysfunctional, insincere, strong. Gjithashtu, në fokus janë ushtrime që lidhen me idioma si: tight-knit, distant, dysfunctional, insincere, strong. Sëfundmi, ushtrimet e gramatikës lidhen me kohët e së shkuarës.					
4		Shkrimi i letrave dhe emailleve joformale. Letrat/Emaillet joformale u dërgohen personave të cilët ne i njohim si miq apo dhe të afërm. Ato përmbajnë përvoja, japin lajme, bëjnë ftesa, pranojnë ose refuzojnë ftesa. Gjithashtu mund të përdoren për të dhënë apo marrë këshilla, falenderime, për të bërë sqarime apo shprehur preferenca. Në përgjithësi, mund të përmbajnë më shumë se një tematikë.					

5	Module 2. Tejkalimi i kufijve, shikimi drejt së ardhmes, ndërtimi i një njeriu bionic, analizë teksti. Tema kryesore e kapitullit lidhet me të ardhmen, zhvillimet teknologjike. Lidhja midis njerëzve dhe teknologjisë paraqitet si e debatueshme. Teknologjia është në të njëjtën kohë e dobishme dhe fitimprurëse. Teksti mbi ndërtimin e një njeriu bionik paraqet si teknologjia është përafruar dhe po tejkalon cilësitë e njerëzores.
6	Fjalor, kërkimi, teknologji, pajisje, fjalë të bashkëvendosura, idiomë, fjalëformim. Studentëve u jepen ushtrime të ndryshme për plotësim. Fillimisht, ata praktikojnë fjalë si mind-boggling, intuitive, pertinent, self-regulating me anë të ushtrimeve të ndryshme. Ushtrime që kanë të bëjnë me teknologjinë vijojnë për të përfunduar me ushtrime që lidhen me idioma mbi teknologjinë dhe fjalëformimin.
7	Module 3. Të zgjerojmë horizontin, sipërmarrës të rinj, fjalor, letra gjysmë-formale. Studentët ftohen të bëjnë stuhi mendimesh mbi mënyrën se si ata mund të zgjerojnë horizontin e tyre dhe mbi kënaqësinë në punë. Sesioni vazhdon me pjesën e leximit dhe studentët plotësojnë ushtrime që kanë të bëjnë me fjalorin dhe analizën e tekstit. Pjesa e të shkruarit lidhet me letrat gjysmë-formale.
8	Provim Gjysmëfinal
9	Module 4. Shëndeti emocional, mirëqënia e brendshme, çfarë fshihet pas një të qeshure, fjalor. Studentët bëjnë stuhi mendimesh mbi shëndetin emocional dhe mirëqënien e brendshme. Pjesa e leximit trajton çfarë fsheh një buzëqeshje. Shembull është marrë portreti i Mona Lisës. Në përfundim punohet me ushtrime fjalori.
10	Folje modale, shprehje modale, të shkruajmë një ese të bazuar mbi stimuj. Një shumëllojshmëri ushtrimesh u jepet studentëve të praktikojnë foljet modale që shprehin mundësi, nevojë, mungesë nevojë dhe detyrim. Në pjesën e të shkruarit, studentët udhëzohen të shkruajnë një ese të bazuar mbi stimuj apo ide të dhëna.
11	Module 5. Çfarë është inteligjenca në ndërgjegje sociale, investigues i krimeve mjedisore, analizë teksti, fjalor. Studentët bëjnë stuhi mendimesh mbi çfarë është inteligjenca në ndërgjegje sociale dhe çfarë do të thotë të jesh qytetar botëror. Teksti i leximit ka të bëjë me investigues të krimeve mjedisore dhe shoqërohet me ushtrime të analizës së tekstit që ndihmojnë studentët të kuptojnë më mirë tekstin.
12	Forma passive, shkaktore, shkrimi i raporteve. Pjesa e gramatikës përmban ushtrime mbi format pasive dhe shkaktore.
13	Pjesa e të shkruarit trajton udhëzime si mund të shkruash një raport. Studentët lexojnë shembuj të ndryshëm raportesh, përcaktojnë stilin e saktë, lidhin pjesët e hyrjes me ato të përfundimit, zgjerojnë paragrafë dhe shkruajnë një raport.
14	Përsëritje, fjalor, të shkruarit dhe gramatika. Përsëritje e fjalorit dhe e moduleve të para. Përsëritje e aftësive të të shkruarit me fokus në letra dhe emaile informale. Studentët rikujtojnë dhe shkrimin e një propozimi.
15	Përsëritje, fjalor, të shkruarit dhe gramatikë. Përsëritje e moduleve 3, 4 dhe 5. Studentët përsërisin fjalorin dhe gramatikën e moduleve 3, 4 dhe 5. Në përfundim, ata fokusohen në shkrimin e esëve dhe letrave gjysmë formale, esëve të bazuara mbi stimuj.
16	Provim Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.		
Literatura	• Cohen , R., Miller J.(2014) Northstar Reading and Writing Advanced. Pearson Longman. • On screen Virginia Evans C1		
Referenca të tjera	• VOA Special English • Oxford dictionary, www.oup.com/elt/headway		
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat			
1	Studentët do të mund të kuptojnë dhe komentojnë tekste komplekse bazuar në argumente të veçanta e me tematikë të ndryshme .		
2	Përvetësimi i aftësive e të dëgjuarit nëpërmjet një sërë aktiviteteesh		
3	Zhvillimi i aftësive të të shkruarit nëpërmjet stileve dhe llojeve reale të të shkruarit		
4	Përforsimi i kuptimit të strukturave gramatikore.		
5	Përvetësimi i aftësive të të lexuarit nëpërmjet skimming, scanning, intensive reading etc.		
6	Zhvillimi i aftësive të të folurit nëpërmjet aktiviteteve të të folurit.		
Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	1	30	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final		70	
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final		30	
Total		100	
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	0	0
Detyra	1	0	0
Gjysmë finale	1	25	25
Provimi final	1	30	30
Të tjera	1	35	35
Ngarkesa totale e orëve			154
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.16
ECTS			6.00